



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.956/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj, Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut Islam Gashi nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si i bazuar apeli Anr.956/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, Islam Gashi nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal për vendvotimin: 0704D/01R, 0706D/02R, 0703D/02R.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, në Komunën e Kaçanikut, në Vendvotimin: 0704D/01R, 0706D/02R, 0703D/02R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.956/2021, i paraqitur nga Islam Gashi, Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, me të cilën pretendon se në vendvotimet 0704D/01R, 0706D/02R, 0703D/02R., se ka mos përputhje në mes të formularëve dhe votave që figurojnë në rezultatet e KQZ-së dhe kjo dëshmohet edhe me anë të deklaratave që janë të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje Islam Gashi, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartcekura, PZAP,

pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimet e lartcekur është i bazuar.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Qendrave të Votimit, te vendosura si ne pikën -II- te dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se ne Rezultatet përfundimtare nga KQZ, të Kandidateve në Vendvotimet 0704D/01R, 0706D/02R, 0703D/02R, nuk përputhën votat në këto vendvotimet, me deklaratat e votuesve të bashkangjitur në shkresat e lëndës. Në vendvotimin 0704D/01R, për kandidatin në fjalë në rezultatet përfundimtare të publikuara nga ana e KQZ-së, ka rezultuar se ka gjithsej 3 vota, ndërsa në shkresat e lëndës kemi të bashkangjitur 5 deklarata të votuesve të cilët kanë deklaruar se ka votuar në këtë vendvotim për kandidatin e lartcekur. Në vendvotimin 0706D/02R, nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga ana e KQZ-së, ka rezultuar se ka gjithsej 1 vota, ndërsa në shkresat e lëndës kemi të bashkangjitur 2 deklarata nga votuesit të cilët dëshmojnë se kanë votuar në këtë vendvotim, për kandidatin e lartcekur. Në vendvotimin 0703D/02R, nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga ana e KQZ-së, ka rezultuar se ka gjithsej 1 vota, ndërsa në shkresat e lëndës kemi të bashkangjitur 2 deklarata nga Votuesit të cilët dëshmojnë se kanë votuar në këtë vendvotim, për kandidatin e lartcekur. Sipas deklaratave të votueseve të bashkangjitura në apel e që ndërlidhen me këto QV, kemi me shumë deklarata si dëshmi që deklarojnë se kanë votuar të njëjtin mirëpo këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratat e votueseve andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këto vendvotime e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 956/2021 më datën 07.11.2021.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.